




REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060/01-54601 dt. 03/11/ 2023

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të Drenasit z.Milaim Hajdari, me dt. **10.11.2023** e premtë, duke filluar në ora 10:00 në sallën e Bordit të Komunës.

THËRRET
Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja do të këtë:


Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 20.10.2023.
2. Propozim vendim për dhënien e mjeteve financiare.
3. Të ndryshme.

Drenas, 03.11.2023



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Milaim Hajdari



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 02.060-5460 dt. 03.11 2023

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. **20.10.2023**, ora 10:00.

Mbledhjen e kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Hamit Kastrati (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), Florentina Elezi-Veliu (VV) si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend Dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt. 20.09.2023.
2. Raporti Financiar Janar-Shtator 2023.
3. Propozim vendim për plotësim ndryshimin e caktimit të normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024.
4. Draft propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa tarifa, ngarkesa dhe gjoha.
5. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Xhevat Qorri.
6. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Anita Kastrati.
7. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Lirije Prenku.
8. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Liridona Hasani.
9. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Dorentina Shehu.
10. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Sabahate Gashi.
11. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Argjira Gjinofci
12. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Viola Dibrani.
13. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Valdrin Istogu.
14. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Taulant Mziu.

15. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Rijon Ramadani.
16. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Gentian Bujupi.
17. Të ndryshme..

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovc: mos me thënë më saktësisht që jam në dilemë, dy propozim-vendime për dhënien e pronave në shfrytëzim, a me i sjellë këtë mbledhje, jam me shty edhe pak për një sqarim eventual. Unë besoj që edhe tash na jemi në rregull, kemi dashtë me mbajtë me një konferencë me Izraelite, mirëpo nuk kanë mujt me ardh për shkak të situatës atje, ndërsa përfaqësues këtu që unë unë kanë qenë, na e kemi bo një procesverbal, përveç atyre që ju keni negocua ata, tani ua sjelli, ata kur kanë ardhë me dy propozime për dy prona, po na njërën s'kenë mujt me me ja u dhanë për shkak se kategoria e pronës është më e lartë sesa që kërkohet aty. Na jemi proces të saj. Na besojmë që ajo kategoria e asaj tokës nuk është, në qoftë se kjo kategori e pronës kalon kategorinë pesë, atëherë me e pas si parasysh, si shtysë që me ia dhanë atyre domethënë kur të vjen një moment tjetër, mos me ja dhanë tjetërkujt, unë e kam thënë që unë me ligj nuk kam drejtë me bo atë gjë, na mujm me ia propozu Kuvendit se Kuvendi si propozim, si sugjerim, se nuk është vendim domethënë, mundet me lanë diku, si sugjerim mundet me me negociu në të ardhmen atë pronë, në rast se ajo e merr statusin e kategorisë së pronës së Komisionit të pesë, ose gjashtë, ose shtatë, mas një Komisionit të Ministrisë së Bujqësisë, sepse Ministria e Bujqësisë e përcakton ose e bën vlerësimin kur na kërkojmë të pronave, nuk e bëjmë na. Edhe kam propozim-vendim, në kanë ardh kërkesa për shërim për kancer, me ju thanë të drejtën nuk mund me i me i shqyrtusubvencionet që nuk i kemi të shpenzu në kategori tjera, a kemi të drejtë me a do të m'i kalu në Kuvend apo kemi të drejtë me subvencionu. Nëse na konsiderojnë që duhet me me bo më shumë, me i dhënë më shumë se një mijë e pesëqind euro, e sjellim në Kuvend, si propozim. Edhe nëse na lejohet me i pagu prej kodeve tjera.

Hamit Haxhiu: Para se me votuara rendit të ditës, unë kisha dhënë një propozim për objekti, një "Flutura Akademi" kerkoj me hy si pikë e veçantë do të diskutohet rreth "Flutura Akademi. Kuptohet se ato janë diku një një mijë e pesëdhjetë nxënës që e njehin këtë program dhe kisha propozu që qikjo pikë me shku si pikë e rendit të ditës për mbledhjen e Kuvendit.

Arbër Halilaj: edhe unë e kam të njëjtën kërkesë, për shkak që prej disa prindërve që më kanë shkru, pse nuk është vazhdu çështja e kontratës këtu? Janë dhënë disa sqarime, po nëse ka mundësi në seancën e radhës, drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport, së paku të dalë me një raport të aktivitetëve në këtë Akademi, sa trajnime janë kry sa pjesëmarrës krejt dhe natyrisht për shkak transparencës edhe prindërve që pysin çështjen e mos vazhdimit të kontratës.

Florentina Elezi-Veliu: Kena pas si Vetëvendosje shumë thirrje dhe kërkesa në lidhje me çështjen e "Flutura Akademi" Ne kena kërku sot në mëngjes edhe qasim dokumente zyrtare, po do ishte më e mira që në seancë me ardh me një raport se çka realisht ka ndodhë dhe është duke ndodhë?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: krejt komunikimet, kujt i intereson, jua jap unë. “Flutura Akademi” Komunikim zyrtar kanë ba kërkesë për vazhdim, na e kena pritë momentin, unë nuk rri me letra në dorë, se ata janë po mrena, nuk jemi punë jashtë. Edhe në një moment ata kanë shkru kanë çu e-mail që ë ju kërkojmë me ba komisionin për pranid-dorëzimin e objektivë dhe na janë e ke këna akceptu menjëherë. Kërkosh s’mundet me përdor një objekt publik për politikë Vendimin unë e marrë vendimin

Pas sugjerimeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota “Për”, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur Të dt. 20.09.2023.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Raporti Financiar Janar Shtator 2023.**

Meqë nuk pati diskutime u sugjerua kjo pike e rendit të ditës për kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim vendim për plotësim ndryshimin e caktimit të normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024.**

Shyqiri Bublaku: Pas aprovimit të propozim-vendimit nga ana e Kuvendit të normave tatimore për vitin dy mijë e njëzet e katër, kemi marrë një njoftim nga MAPL-ja se duhet të bëhet rishqyrtim i këtij propozim-vendimi dhe kemi kërku sqarim nga Departamenti i Tatimit në Pronë, ku na u ka dhënë mundësia që normat tatimore të i zvogëlojnë për vitin 2024, ndërsa normat që i kanë paraqitë në ligjin e për plotësim-ndryshimin e ligjit janë kohë norma për vitin 2025 ku kemi shku me normën më të ulët, domethënë me 0.10 për të gjitha kategoritë, sepse edhe këto na kanë pru njoftimin Departamenti i Tatimit në Pronë që kuvendet komunale mund të nxjerrin vendime për caktimin e normës tatimore si për 2023 me ndryshim që mund të ulin normën tatimore nga 0-15 nën 0-15 për secilën kategori të pronës, kështu që ne kemi shku me 0.10 për secilën kategori pronës, kështu që t'i po favorizojmë qytetarët tonë masi na u ka më mundësia për këtë gjë.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katër të rendit të ditës: **4. Draft propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa tarifa, ngarkesa dhe gjoba.**

Agnesë Kastrati Bucolli Drejtoreshë e Zhvillimit Ekonomik: Tek neni trembëdhjetë, pas verifikimeve të detajuara del se ka nevojë të bëhen disa korigjime tekstuale tek përshkrimi i

kodeve, domethënë kodet dhe vlerat e taksës mbetet e njëjta, vetëm korrigjohet teksti sipas ARBK-së. Pra, prej ka qenë shumicë shitje me pakicë, ne në bazë të ARBK-së e kemi ndryshu dhe kemi ba vetëm tregti me pakicë, vlera nuk ndryshon, asgjë. Ndërsa pasi komisioni e ka përfundu raportin, ne na duhet edhe një në një propozim për ndryshimin e nenit tre pikë dy pikë shtatë, subjektet ekonomike, tarifën e caktuar sipas nenit trembëdhjetë të kësaj Rregullore, do ta bëjnë në afat prej tridhjetë ditësh nga dita e pranimit të faturës së bashku me vërejtjen. Atëherë propozohet të bëhet ky ndryshim tek nenit trembëdhjetë pikë dy pikë shtatë, subjektet ekonomike, tarifën e caktuar trembëdhjetë të kësaj Rregullore, do ta paguajnë brenda vitit fiskal dhe në rast të mos pagesës së taksës, pas përfundimit të vitit fiskal, lënda do të procedohet për inkasim të detyrueshëm përmes in inicimit të procedurave përmbartimore.

Lumnije Krapi Drejtoreshë e Shëndetësisë: pas shqyrtimit të mënyrë të detajuar të Rregullores, edhe pasi e kanë përfundu punën, po duke marrë parasysh se shërbimet që kryhen në Qendrën e Mjekësisë Familjare me Udhëzimin Administrativ 2017, mirëpo me Udhëzimin Administrativ 2020 duhet të hekën disa nga shërbime, meqenëse nuk kryhen në Qendrën e Mjekësisë Familjare, në bazë të Udhëzimit. Domethënë kryhen në nivelin sekondar. Kështu që bre prej kolonës prej pikës njëzetënjë deri në njëzetënjë pikë pesëdhjetë e tre, keto shërbimet duhet të hiqen prej Rregullores.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë deri tek pika e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës, Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati. U rekomanduan për mbledhjen e Kuvendit Komunal këto propozim vendime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës: **17 Të ndryshme.** Nuk pati diskutime.

Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur mbledhjen, mbledhja përfundoj rreth orës 10:35 min .

Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Milaim Hajdari



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

01 Nr. 400-54202 dt. 01/11/2023

Në vështrim të nenit 13, dhe 58, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon që në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1, 12.2 pika d, dhe nenit 40, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Nr. 12-320-19338, dt. 7.4.2017, Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.4.2022, si dhe Kërkesës të Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Nr. 01-400/03-53696, të datës 30.10.2023, për Kuvendin e Komunës, Kryetari i komunës, jep këtë:

PROPOZIM VENDIM për dhënien e mjeteve

Neni 1

Aprovohet kërkesa e Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Prishtinë, Nr. 01-400/03-53696, të datës 30.10.2023, për ndihmë financiare për këtë qendër, në shumën prej 3,000.00 euro, nga kategoria e shpenzimeve: Subvencione dhe transfere, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjente, në numrin e llogarisë XK051110052260000121.

Neni 2

Mjetet financiare të aprovuara sipas këtij Vendimi do të paguhen nga pozicioni, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, kodi ekonomik XK051115220000121, të parapara me buxhetin e vitit 2023 të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencia.

Neni 3

Ky propozim vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga Kryetari i Komunës së Drenasit.


Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

Ju dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit
- Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve - Prishtinë
- DShPE
- DF

ARSYETIM

Me datë 30.10.2023, pranë Zyrës së Kryetarit, është adresuar kërkesa e Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Prishtinë, Nr. 01-400/03-53696, të datës 30.10.2023, ku është adresuar nevoja për mbështetje financiare për këtë qendër.

Komuna e Drenasit brenda kompetencave të saja ligjore dhe buxhetore, e ka të rregulluar këtë çështje përmes Rregullores së brendshme komunale - Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017 si dhe rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.04.2022 e cila parasheh se Komuna subvencionon në formë të përkrahjes financiare OJQ-të, sipas kritereve të përcaktuara me të njëjtin dokument/rregullore, ku edhe duke u bazuar në këtë, përmes këtij dokumenti, propozohet që në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda kompetencave, Kryetari propozon të aprovohet kërkesa e cekur më lartë.